

VENDIM
Nr.1030, datë 9.7.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.411, DATË 9.6.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE NË BASHKINË SARANDË, TË QARKUT TË
VLORËS”, DHE PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE
DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË
QEVERISJES VENDORE, BASHKIA SARANDË, TË QARKUT TË VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.411, datë 9.6.2005 të Këshillit të Ministrave, të shtohet edhe lista me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 383 (treqind e tetëdhjetë e tre), e pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të njësisë së qeverisjes vendore, bashkia Sarandë të qarkut të Vlorës.

2. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që do t'i transferohen në pronësi të kësaj njësie.

3. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 16 (gjashtëmbëdhjetë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Sarandë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2.FORMULAR PER TRANSFERIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETETRORE
(Mbeshtetur ne inventarizimin e pronave te vecanta te tipit pyje, kullota.Livadhe,shkembore etj)

Institucioni i Pushtetit Qendror: MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJERAVE,										
Bashkia : Sarande Identifikoi: Granit Shehu Supervizoi: Zylfo Pasha Kryetari i Bash: Edmond Gjoka Drejtori i DSHP: Jani Babi										
Fusha e perdorimit te prones: Pyje, Kullota etj.										
Nr.	Nr i INV	Emertesa e Ekonomise Pyjore/Kullosore	Emertesa e Ngastres Vendodhja (sipas emertimit popullore)	Nr. i ngastr	Destinacioni	Sip. ne ha	Funksini per te cilin perdoret prona	Institucioni Enti me Pergjegjesi Administrative	Institucioni Enti perdorues Statusi Juridik	Te dhena te tjera (shenime te vecanta)
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	368	Heremec	Lekurez	19	Kullote	85	Kullote	MMPAU	B.Sarande	
2	369	Heremec	Dardhe	1	Kullote	172	Kullote	MMPAU	B.Sarande	
3	370	Heremec	Dardhe	2	Kullote	83	Kullote	MMPAU	B.Sarande	
4	371	Heremec	Limjoni	3	Kullote	60	Kullote	MMPAU	B.Sarande	
5	372	Ek. Pyj. Bregdet	Faqja mbi marine	131	Pyll	45,50	Pyll	MMPAU	DSHP	
6	373	Ek. Pyj. Bregdet	Mbi stadium	132	Pyll	18,50	Pyll	MMPAU	DSHP	
7	374	Ek. Pyj. Bregdet	Mbi f.sportit	133	Pyll	44,00	Pyll	MMPAU	DSHP	
8	375	Ek. Pyj. Bregdet	Mbi kamin	134	Pyll	58,50	Pyll	MMPAU	DSHP	
9	376	Ek. Pyj. Bregdet	Cfaka	135	Pyll	16,00	Pyll	MMPAU	DSHP	
10	377	Ek. Pyj. Bregdet	Hamalloi	136	Pyll	40,00	Pyll	MMPAU	DSHP	
11	378	Ek. Pyj. Bregdet	Faqja lindore e qytetit	137	Pyll	47,50	Pyll	MMPAU	DSHP	
12	379	Ek. Pyj. Bregdet	Depo e ujit	138	Pyll	27,50	Urbane	MMPAU	B.Sarande	
13	380	Ek. Pyj. Bregdet	Faq. Lind. Lekursit	139	Pyll	17,00	Pyll	MMPAU	B.Sarande	
14	381	Ek. Pyj. Bregdet	Faq.Per. Lekursit	140	Pyll	30,00	Urbane	MMPAU	B.Sarande	
15	382	Ek. Pyj. Bregdet	Gurore	141	Pyll	40,00	Urbane	MMPAU	B.Sarande	
16	383	Ek. Pyj. Bregdet	Mbi Cuke	142	Pyll	46,50	Urbane	MMPAU	B.Sarande	

V.K.RR.T.R.SH
Nr. 3, date
19.02.1999

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
368-383	Pyll, kullotë etj	Në pronësi